

UDHËZIM
Nr. 25, datë 1.9.2023

**PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NORMAT E PUNËS MËSIMORE
NË OFRUESIT E ARSIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të shkronjës “b”, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Numri i nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në ofruesit e arsimit profesional janë si më poshtë:

I. Numri i nxënësve për klasë, numri i drejtuesve dhe norma mësimore javore e mësuesve dhe e drejtuesve

1. Numri i nxënësve për klasë:

- a) Klasat në arsimin profesional formohen jo më pak se 15 nxënës;
- b) Në drejtimet mësimore “bujqësi”, “veterinari”, “pyje”, “ndërtim”, “detari”, “gjeologji-miniera”, “kërkim, shpim dhe shfrytëzim i naftës dhe gazit” dhe “tekstil-konfeksion” klasat formohen me jo më pak se 12 nxënës;

- c) Klasat në arsimin pas të mesëm formohen jo më pak se 10 nxënës.

2. Ndarja e klasave paralele të bëhet sipas këtij rregulli:

- a) dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 30–59;
- b) tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 60–90;
- c) katër klasa paralele, kur numri i nxënësve është 91–120;
- d) pesë klasa paralele, kur numri i nxënësve është 121–150;
- e) ndarja e nxënësve në më shumë se pesë klasa paralele bëhet për çdo rritje të numrit me 30 nxënës.

3. Numri i drejtuesve:

- a) Kur numri i nxënësve është 200–450, emërohet një nëndrejtor shkolle;
- b) Kur numri i nxënësve është 450–700, emërohen dy nëndrejtorë shkolle;
- c) Kur numri i nxënësve është mbi 700, emërohen tre nëndrejtorë shkolle.

4. Norma mësimore javore e mësuesve dhe e drejtuesve

- a) Normat për lëndët e kulturës së përgjithshme:

- i. Mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë 18 orë në javë;
- ii. Mësuesi i: gjuhës së huaj, matematikës, 20 orë në javë;
fizikës, biologjisë, kimisë, informatikës,
historisë, gjeografisë, teknologjisë, shkencave
shoqërore (filozofi, psikologji, qytetari,
sociologji), ekonomisë dhe mësuesi ndihmës
- iii. mësuesi i lëndëve të tjera 22 orë në javë.

- b) Normat për lëndët e kulturës profesionale:

- i. Mësues i teorisë profesionale 20 orë në javë;
- ii. Mësues i praktikës profesionale 22 orë në javë.

- c) Normat për drejtuesit:

- i. drejtori i shkollës, pavarësisht nga numri i nxënësve
- ii. nuk ka ngarkesë mësimore
- iii. nëndrejtori, pavarësisht numrit të nxënësve 6 orë në javë;
- iv. përgjegjësi i njësisë së zhvillimit, pavarësisht numrit të nxënësve norma është 50 % e ngarkesës së orëve mësimore javore
- v. përgjegjësi i bazës prodhuese 15 orë në javë.

Nëndrejtorët e shkollës dhe përgjegjësi i bazës prodhuese e plotësojnë normën e tyre mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë.

5. Norma e vlerësimit të arritjeve

- a) Drejtori i institucioneve publike ofruese të AFP-së, me 81–700 nxënës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor);
- b) Drejtori i institucioneve publike ofruese të AFP-së me mbi 700 nxënës: 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor);
- c) Nëndrejtori i institucioneve publike ofruese të AFP-së me 81–700 nxënës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor);
- d) Nëndrejtori i institucioneve publike ofruese të AFP-së me mbi 700 nxënës: 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).

II. Organizimi i mësimin në arsimin profesional

- 1. Orët teorike zhvillohen me të gjithë klasën në lëndët e teorisë profesionale.
- 2. Orët e praktikës profesionale zhvillohen në grupe me jo më shumë se 15 nxënës, sipas drejtimeve dhe profileve.

III. Dispozita të veçanta

- 1. Ngarkesë mësimore javore është numri i orëve mësimore që i ngarkohet punonjësit arsimor për çdo javë të vitit mësimor. Ngarkesa mësimore javore përfshin orët e mësimin të çdo lënde që përmban plani mësimor dhe çdo orë të përcaktuar në këtë udhëzim.
- 2. Mësuesi i lëndëve të kulturës së përgjithshme, mësuesi i teorisë profesionale dhe i praktikës profesionale plotëson normën mësimore javore me lëndë të profilit të diplomës që zotërojnë.
- 3. Në rastet kur mësuesi nuk ka orë të mjaftueshme në profilin e diplomës që zotëron, mësuesi ngarkohet me orë mësimore të profileve të përafërta si vijon:
 - a) Mësuesi i lëndëve të përgjithshme, e plotëson ngarkesën javore me orë mësimore të profileve të përafërta, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi;
 - b) Mësuesi i teorisë dhe i praktikës profesionale, i plotëson me orë mësimore të përafërta me profilin e diplomës së tij;
 - c) Në arsimin e mesëm profesional, për shpërndarjen e ngarkesës mësimore sipas profileve dhe për përcaktimin e mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore, drejtoritë e shkollave së pari do të plotësojnë me orë mësimore mësuesit që janë diplomuar në lëndën/profilin sipas përcaktimeve të pikave 4 dhe 5, të kreut I dhe shtojcës 1 të këtij udhëzimi.
- 4. Puna e mësuesit kujdestar barasvlerësohet me 2 orë mësimore në javë.
- 5. Mësuesi që drejton bibliotekën e shkollës i llogariten:
 - a) 2 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka deri në 300 nxënës;
 - b) 3 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 301–600 nxënës;
 - c) 4 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 600 nxënës.

6. Mësuesi drejtues i departamentit mësimor (përgjegjës i departamentit të kulturës profesionale) dhe mësuesi drejtues i ekipit lëndor (kryetar i ekipit lëndor, kultura e përgjithshme) i ulen 2 orë mësimore në javë.

7. Mësuesit që janë pjesë e njësisë së zhvillimit ju ulen orët sipas llogaritjeve, si më poshtë vijon:

a) Formula e llogaritjes së ngarkesës totale javore të angazhimit të anëtarëve të njësisë së zhvillimit është:

$K1 \times \text{numrin e nxënësve} + K2 \times \text{numrin e drejtimeve mësimore} = \text{numrin e orëve mësimore javore}$, ku koeficienti $K1 = 0,02$ dhe koeficienti $K2 = 2$

b) Në ngarkesën mësimore totale javore të llogaritur sipas kësaj formule, nuk përfshihet ngarkesa mësimore javore e përgjegjësit të njësisë së zhvillimit, e cila përcaktohet sipas pikës 3 të këtij udhëzimi.

8. Mësuesi që merret me veprimtaritë artistike dhe mësuesi që kryen detyrën e koordinаторit të qeverisë së nxënësve, për shkollat nën 700 nxënës i llogariten 2 orë në javë dhe për shkollat mbi 700 nxënës i llogariten 4 orë në javë.

9. Mësuesi, në shkollat me më shumë se 700 nxënës, që kanë palestër dhe krijojnë e stërvitin ekupe sportive, jo në më shumë se dy lloje sporti për femra dhe meshkuj, i ulet norma mësimore javore me 3 orë në javë.

10. Mësimi në lëndën e edukimit fizik zhvillohet i ndarë, sipas gjinisë dhe kur është e mundur mësuesi të jetë i së njëjtës gjini me nxënësit. Ndarja sipas gjinisë bëhet sipas kësaj rregulle:

a) në institucionet e arsimit të mesëm profesional, kur numri i nxënësve për çdo gjini është jo më pak se 10 nxënës, mësimi i edukimit fizik u bëhet i ndarë në gjini;

b) në ofruesit e arsimit të mesëm profesional që kanë klasa paralele, kur numri i nxënësve për çdo gjini në të paktën një paralel, është më i vogël se 10 nxënës, mësimi i edukimit fizik të bëhet i ndarë në gjini, por duke bashkuar dy paralele;

c) në ofruesit e arsimit të mesëm profesional, që nuk kanë klasa paralele, kur numri i nxënësve për çdo gjini është më i vogël se 10, mësimi i edukimit fizik të bëhet pa u ndarë në gjini.

11. Mësuesve që vlerësojnë testimet e provimeve kombëtare të arsimit bazë, t'u llogaritet për efekt pagese orë mësimore për 3 teste të vlerësuara.

12. Mësuesve që vlerësojnë fazën II të olimpiadave kombëtare të organizuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, t'u llogaritet për efekt pagese 1 orë mësimore për 3 teste të vlerësuara.

13. Çdo anëtar i të komisionit të vlerësimit të provimeve të teorisë dhe praktikës profesionale, t'u paguhet një orë mësimore, për çdo 10 nxënës që marrin pjesë në provim.

14. Mësuesit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit/informatikës, i cili është i ngarkuar nga shkolla me administrimin e SMIP-it, i zbriten 2 orë mësimore javore.

15. Mësuesit mbikëqyrës të Maturës Shtetërore i ulet norma me 2 orë mësimore në javë.

16. Të gjitha normat e veçanta, të përcaktuara në kreun V e këtij udhëzimi, për efekte financiare kanë vlerën e orës mësimore.

17. Mësuesit, të cilëve u është ulur ngarkesa për kryerjen e veprimtarive të ndryshme të përcaktuara në këtë udhëzim, nuk mund të ngarkohen me orë shtesë të pagueshme.

18. Masa e pagesës për orën mësimore mbi ngarkesën mësimore javore bëhet sipas tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

19. Çdo orë mësimore e realizuar nga mësuesi mbi ngarkesën mësimore javore të tij paguhet si orë mbi normë, në fund të çdo muaji.

20. Në arsimin e mesëm profesional mësuesi lejohet të ketë orë mbi normë/ngarkesë jo më shumë se 30% të ngarkesës mësimore javore.

21. PAGESA E ORËVE SHITESË BËHET DETYRIMISHT NË FUND TË ÇDO MUAJI. DREJTORIA E SHKOLLËS TË LLOGARISË PERIODIKISHT PAGESAT E ORËVE SHITESË, ME QËLLIM QË PAGESA E ORËVE SHITESË TË PËRFITUARA NGA MËSUESIT GJATË MUAJIT PËRKATËS, TË JETË NË PËRPTHJE ME ORËT FAKTIKE TË REALIZUARA NGA MËSUESI.

IV. Dispozitat e fundit

1. Normat e punës mësimore dhe numri i nxënësve për klasë në ofruesit e arsimit profesional, do të jenë si më sipër, duke filluar nga viti shkollor 2023–2024.

2. Udhëzimi nr. 28, datë 14.10.2019, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit profesional”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësimit, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe ofruesit publik të arsimit profesional.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj

SHTOJCË 1

ARSIMI PROFESIONAL DHE MËSUESIT SIPAS PROFILIT

a) Kurrikula bërthamë

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1	Gjuhë shqipe	Gjuhë shqipe dhe letërsi	
2	Letërsi	Gjuhë shqipe dhe letërsi	
3	Gjuhë e huaj e parë	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...)	
4	Matematikë	Matematikë, matematikë-fizikë	Fizikë
5	Fizikë	Fizikë, matematikë-fizikë	Matematikë
6	Kimi	Kimi, biologji-kimi	
7	Biologji	Biologji, biologji-kimi	
8	Histori	Histori, histori-gjeografi	Gjeografi
9	Gjeografi	Gjeografi, histori-gjeografi	Histori
10	Qytetari	Shkenca sociale	Histori-gjeografi
11	Filozofi	Shkenca sociale	Filozofi
12	Ekonomi	Shkenca sociale	Ekonomi
13	TIK	Informatikë, TIK, matematikë-informatikë	Matematikë
14	Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti	Edukim fizik	

b) Kurrikulat me zgjedhje

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1	Letërsi	Gjuhë shqipe dhe letërsi	
2	Gjuhë e huaj e dytë	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...)	
3	Fizikë	Fizikë, matematikë-fizikë	Matematikë
4	Kimi	Kimi	Biokimi
5	Biologji	Biologji, biologji-kimi	Kimi
6	Histori	Histori, histori-gjeografi	Gjeografi
7	Gjeografi	Gjeografi, histori-gjeografi	Histori
8	Psikologji	Shkenca sociale	Filozofi, histori-gjeografi
9	Sociologji	Shkenca sociale	Filozofi, histori-gjeografi
10	Teknologji	TIK, Fizikë	Shkencat e natyrës, Informatikë, Inxhinieri
11	TIK	Informatikë, TIK, matematikë-	Matematikë, fizikë

		informatikë	
12	Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti	Edukim fizik	
13	Arte	Arti skenik, muzikë, art figurativ	Gjuhë shqipe dhe letërsi